



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:027517
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05429704

E.nr.565/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarrimit të kreditorëve: A.B. nga Ferizaj, M.H. nga Ferizaj, F.R. nga Ferizaj, K.A. nga fsh ... K. Viti dhe M.T. nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsim, për pagesën e shumës në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarrimore në lëndën E.nr.565/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.565/23, të datës 08/05/2023, e ka caktuar përmbarrimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsim, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 400/2020, të datës 10.02.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarrimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15/9/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 8,822.97 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarrimore në këtë çështje juridike përmbarrimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.565/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi